



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I TRANSPARENCËS DHE KUFIZIMIT TË PËRKOHSHËM TË
ÇMIMEVE TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE
TË NAFTËS DHE GAZIT

V E N D I M

Nr. 2, Datë 28.03.2026

PËR

PËR MIRATIMIN E ÇMITIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË
TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të çmimeve të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 186, datë 19.03.2026 “Për shpalljen e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve”, si dhe në zbatim të nenit 21/3 dhe nenit 21/5 të Ligjit 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Të miratojë çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës, për Benzinë të standardit SSHEN 2282018, Gazoil të standardit SSHEN 5902018 dhe gazin e lëngshëm të naftës (Propan/Butan). Çmimet e miratuara nga Bordi, të cilat reflektojnë çmimet e nënprodukteve në Bursë, të publikuara nga agjencia ndërkombëtare “S&P Global Platts” në USD, në kushtet e lëvrimit FOB Med, detyrimet doganore/tatimore që aplikohen, si dhe marzhe bruto maksimale të tregtimit, (përfshijnë edhe TVSH-në) janë çmime tavan/maksimal dhe asnjë operator ekonomik nuk mund ti tregtojë këto nënprodukte mbi çmimet tavan të Vendimit të Bordit. Çdo operator ekonomik me shumicë dhe pakicë, është i lirë ti tregtojë këto nënprodukte me çmime më të ulta se çmimet tavan/maksimale të miratuara në Bord.
2. Çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve janë si më poshtë:
 - a. **Çmimet tavan (max), për shitjen me shumicë të produkteve**
 - 206 Lekë/litri për gazoilin;
 - 169 Lekë/litri për benzinën.

b. **Çmimet tavan (max) për shitjen me pakicë të produkteve**

- 218 Lekë/litri për gazoilin;
- 181 Lekë/litri për benzinën.

3. Efektet e këtij vendimi fillojnë datë 28.03.2026, ora 10:30, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, në zbatim të Ligjit 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.
4. Ky vendim të publikohet në fletoren zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, ministrisë përgjegjëse për ekonominë, ministrisë përgjegjëse për financat dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Znj.Delina Ibrahimaj	Kryetar	Z. Sezar Beqaj	Anëtar
Z. Enea Karakaci	Anëtar	Z. Nimet Veliaj	Anëtar
Znj. Arjana Dyrmishi	Anëtar	Z. Dritan Basha	Anëtar
Z. Ilir Binaj	Anëtar	Z. Arlind Fida	Anëtar
Z. Besmir Beja	Anëtar	Z. Klaudio Gega	Anëtar
Z. Ilia Gjermani	Anëtar		
Z. Mariglen Bregu	Anëtar		